



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.11.2023

FORMULAR I NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË KLASIFIKUAR QË ZHVILLOHET BAZUAR NË LIGJIN NR 36 DATË 16.04.2020 “PËR PROKURIMET NË FUSHËN E MBROJTJES DHE TË SIGURISË” PËR PUBLIKIM NË BULETININ E NJOFTIMEVE PUBLIKE DHE FAQEN ZYRTARE TË INTERNETIT TË KUVENDIT.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Tiranë

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Kuvendi i Shqipërisë
Adresa Bul. Dëshmorët e Kombit nr.4 Tiranë
Tel/Fax 0355 42 278259
E-mail genci.gjoncaj@parlament.al
Faqja e Internetit www.parlament.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
☒	☐
Njësie Qeverisjes Vendore	Tjetër
☐	☐

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po ☐ Jo ☒

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit :

Urdhri i prokurimit nr. 3394/3 prot.datë 09.11.2023 .

2.2 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po ☐ Jo ☒

2.3 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik ☐

Me disa operatorë ekonomikë ☐

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po ☐ Jo ☐

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër

--

2.4 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër:_____ (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.5	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike.	
-----	---	--

2.6 Autoriteti kontraktor / Autoritetet kontraktore, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:

--

2.7 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës :

1.455.200 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind) **Lekë pa TVSH**

2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi**

është _____

3. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:

“Shërbim mirëmbajtje e sistemit të sigurisë me kamera me qark të mbyllur (cctv)”, për 24 muaj .

2.8 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

24 muaj nga nënshkrimi kontratës

2.9 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: ☐☐ ose ditë: ☐☐☐☐ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër (jo më shumë se (5) vjet)

Ose duke filluar nga ☐☐☐☐ (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më ☐☐☐☐ (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër:

KRYESIA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

2.11 Ndarja në LOTE:

Po ☐ Jo ☒

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i LOTEVE

1. _____

2. _____

3. _____
Etj.

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet].

Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka): ☐ ☐

ose: nga ☐ ☐ në ☐ ☐

2.14 .Zvogelimi i numrit të kandidatëve të përshtatshëm (nëse aplikohet):

2.14.1 Do të aplikohet Zvogëlimi i numrit të kandidatëve të përshtatshëm, që do të ftohen:

Po ☐ Jo ☒

2.14.2 Nëse do të aplikohet kriteri për zvogëlimin e numrit të kandidatëve:

i. Të specifikohet numri : _____

ii. Të specifikohen kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për zvogëlimin e numrit të kandidatëve: _____

2.15 Do të pranohen variantet:

Po ☐ Jo ☒

2.15.1 Do të pranohet nënkontraktimi:

Po ☐ Jo ☒

Nëse do të lejohet nënkontraktimi, të specifikohet përqindja e lejuar për nënkontraktim:

Autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtëpërdrejtë nënkontraktorit:

Po ☐ Jo ☒

Shënime të tjera

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

2.17. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas shtojcës 13.

3.1.1 Operatorët ekonomike që shprehin interes për këtë procedurë të paraqesin dhe provojnë paraprakisht që :

- a) Jant të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (statusi aktiv)/në një regjister tregtar profesional në shtetin e tij të origjinës ose të qëndrimit dhe të kenë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- b) Të jenë të pajisur me certifikatë sigurie të vlefshme të nivelit **konfidencial** ose më lart.

Kërkesa (sipasformatit të shtojcës 1 të set-it të DT-ve) dhe depozitimi i kriterëve të pikës a dhe b duhet të bëhet në mënyrë shkresore në protokollin e institucionit , në adresën e AK të cituar në paragrafin 4.3.

Pas depozitimit brenda afatit të pasqyruar në pikën 4.3 të këtij njoftimi të *kërkesës për shprehje interesi* nga OE , AK do të ftojë vetëm ata operatorë ekonomikë që përmbushin kriteret e pasqyruara në pikat a dhe b të këtij paragrafi, për njohjen me pas me dokumentet e tenderit. AK do të njoftojë zyrtarisht operatorët që kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në pikat a dhe b të paragrafit 3.1.1 për modalitetet dhe paraqitjen e tyre pranë godinës së Kryesise së Kuvendit të Shqipërisë në ambientet e çertifikuara në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë (sipas ligjit nr. 36/2020) për njohjen me dokumentet e tenderit, specifikimet teknike , termat e referencës apo çdo material i tjetër të nevojshëm në kuadër të përgatitjes së ofertes së tyre fillestare për këtë kontratatë të klasifikuar.

3.2 Sigurimi i Ofertës:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, sipas Shtojcës 7.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (sipas nenit 14 pika 3 të VKM 1170 datë 24.12.2020) është **29,104** (njëzet e nëntë mijë lekë e njëqind e katër) **lekë**.

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 _____ Lekë

Loti 2 _____ Lekë

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: Me negociim me shpallje paraprake të njoftimit

Procedurë prokurimi e rishpallur

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

I.

a) Numri i referencës (*nr. datë i urdhërit të prokurimit*) i procedurës së anuluar **nr. 273/10 prot. datë 05.06.2023.**

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anuluar
“Shërbim mirembajtje e rrjetit dhe sistemit të monitorimit me kamera me qark të mbyllur (cctv) ” 24 muaj .

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar
1.907.200 (një milion e nëntëqind e shtatë mijë dyqind) Lekë pa TVSH

II.

a) Numri i referencës (*nr. datë i urdhërit të prokurimit*)i procedurës së anuluar **nr. 2767 prot.datë 18.09.2023 .**

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anuluar
“Shërbim mirembajtje e rrjetit dhe sistemit të monitorimit me kamera me qark të mbyllur (cctv) ” 24 muaj .

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar
1.907.200 (një milion e nëntëqind e shtatë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH

Kjo procedurë prokurimi përfshin tre faza kryesore:

Faza 1 - Parakualifikimi: Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktura në dokumentat e tenderit.

Opsioni për zvogëlimin e numrit të kandidatëve të përshtatshëm:

Në njoftim janë përcaktuar kushtet ose rregullat që synohen për të aplikuar në zvogëlimin e numrit të kandidatëve të përshtatshëm. Numri minimal i kandidatëve të përshtatshëm, nuk duhet të jetë më pak se 3(tre).

Në rast të numrit të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm, autoriteti kontraktor duhet të ftojë, të paktën, numrin e kandidatëve që është i barabartë me numrin minimal të paracaktuar të kandidatëve.

Në rast se numri i kandidatëve, që plotësojnë nivelet minimale të aftësisë, është më i vogël se numri minimal, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë me procedurën, duke ftuar një ose më shumë kandidatë që kanë aftësitë e kërkuara.

Kur autoriteti kontraktor merr parasysh se numri i kandidatëve të përshtatshëm është i pamjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të vërtetë, ai mund të pezullojë procedurën dhe të publikojë përsëri njoftimin fillestar të kontratës në fushën e mbrojtjes e të sigurisë dhe të vendosë afatin e ri për dorëzimin e kërkesës për të marrë pjesë. Në këtë rast, ata kandidatë, të cilët janë përzgjedhur në procedurën e pezulluar, si dhe ata të zgjedhur në vijim të njoftimit të dytë të kontratës në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, duhet të ftohen që të dorëzojnë ofertën për të negociuar

Faza 2 – Ftesa për të paraqitur ofertën fillestare: Autoriteti Kontraktor dërgon një ftesë për të dorëzuar oferta fillestare, kandidatëve të cilët kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim.

Autoriteti Kontraktor shqyrton dhe vlerëson ofertat fillestare nëse këto oferta plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Autoriteti Kontraktor fton me shkrim/elektronik të gjithë Ofertuesit që kanë paraqitur ofertat fillestare të kualifikuara, që të fillojnë negociatat me Autoritetin Kontraktor. Autoriteti Kontraktor i zhvillon negociatat edhe në mënyrë të pavarur e individuale me do Ofertues, duke ruajtur parimin e barazisë dhe transparencës. Gjatë këtyre negociatave Autoriteti Kontraktor negocion elementët e ofertës teknike për të përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Faza 3 – Paraqitja e ofertave përfundimtare dhe vlerësimi i tyre: Pas përfundimit të negociatave, Autoriteti Kontraktor fton vetëm ofertuesit që plotësojnë të gjitha kërkesat për dorëzimin e ofertave përfundimtare. Ofertuesit dorëzojnë ofertat përfundimtare, që shqyrtohen nga Autoriteti Kontraktor për t'u siguruar që ofertat janë të kualifikuara. Ofertat përfundimtare të kualifikuara shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kriterëve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët **X**

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐ **pikë** ☐

etj. ☐ **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati i fundit kohor për dorëzimin dhe hapjen kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **14/12/2023** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00** (sipas nenit 29 pika 3/b VKM 1170/2020)

Vendi i dorëzimit të kërkesave : Kryesia e Kuvendit të Shqiperisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit nr 4”, Tiranë.

Zyra e Informacionit te klasifikuar zyra nr 112.

Shënim: Kërkesat për pjesëmarrje duhet të jenë të mbyllura në zarfe jo transparente. Hapja e tyre do të bëhet në datën dhe orën e sipërcituar.

4.4 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 (e shprehur në ditë)

4.5 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip ☒ Anglisht ☐
Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (në rastet kur vlerësohet nga autoriteti kontraktor):

Po ☐ Jo ☒

Nëse Po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit) .

Operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi do të njoftohen në rrugë shkresore hap pas hapi sipas fazave të procedurës lidhur me vendin , modalitetet me njohjen e dokumenteve të tenderit, paraqitjen e ofertave fillestare dhe negociimin e tyre.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **20/11 /2023**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Genci GJONÇAJ

Konceptoi I.Lila
E.Zeqo
A..Cengu

Shënim : Ky formular mbahet ne 2(dy) kopje origjinale

Shtojca 1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE

Emri i Ofertuesit _____

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*/

* * *

Ne, të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi *[jepni detaje të objektit të kontratës sic përcaktohet në Dokumentat të Tenderit]*.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi i ofertuesit

Vula